

Vendim nr. 151 datë 06.07.2023

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Elsa Toska,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.07.2023 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (F) 2023 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **FRAN DASHI**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 3466 akti, datë 24.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2457, datë 21.11.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2023-106, datë 19.01.2023 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: Nenet 42, pika 1, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka qenë mbrojtës i zgjedhur nga shtetasi P.P për përfaqësimin e gjashtë anëtarëve të familjes së këtij të fundit në një çështje penale para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Pukë. Në vijim të një denoncimi publik, në një emision televiziv, në bashkëpunim me shtetasin P.P., Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 367, datë 07.07.2014, ka vendosur, midis të tjerave, deklarinin fajtor të kërkuesit Fran Dashi: “...për veprën penale të moskallëzimit të krimit dhe dënimit e tij me 12 muaj burgim.”. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. 49, datë 11.02.2015 të Gjykatës së Apelit Shkodër. Në lidhje me rekursin e paraqitur nga kërkuesi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2017-558, datë 22.06.2017, ka vendosur mospranimin e tij.

2. Kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues për kundërshtimin e procesit të mësipërm gjyqësor, për të cilin, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me vendimin nr. 263, datë 23.11.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

3. Pas përmbylljes të procesit penal të shpjeguar më lart, në vitin 2018 kërkuesi Fran Dashi ka paraqitur kallëzimin penal nr. 6840 për veprat penale “Mashtrimi”, “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, “Ushtrimi i ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike” dhe “Shpërdorimi i detyrës”, të parashikuara respektivisht nga nenet 143, 244, 245/1 dhe 248 të Kodit Penal (KP), ndaj shtetasit L.M., i cili, sipas kërkuesit, i ka marrë atij (kërkuesit) një shumë parash, me qëllim ushttrimin e ndikimit pranë një prokurori në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, si dhe ndaj shtetasit N.T. (prokurori i çështjes), pasi nuk ka hetuar dhe nuk ka marrë në vlerësim disa prova shkresore.

4. Në lidhje me këtë kallëzim, prokurori ka vlerësuar se ndodhej para gjësë së gjykuar sipas nenit 7 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), dhe në mbështetje të neneve 290/1, shkronja “e” dhe 291 të KPP-së, me vendimin e datës 14.06.2018, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Sipas vendimit të prokurorit, çështja penale me të pandehur shtetasin Fran Dashi për veprën penale “Moskallëzimi i krimit”, të parashikuar nga neni 300 i KP-së, është hetuar dhe dërguar për gjykim dhe gjykatat kompetente kanë dhënë vendime gjyqësore që kanë marrë formë së prerë, në të cilat janë çmuar aktet e administruara gjatë hetimit dhe ato kanë marrë vlerën e provës gjatë gjykimit. Ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr. 6840/2018, kërkuesi ka paraqitur ankim në bazë të neneve 290 dhe 291 të KPP-së.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3466 akti, datë 24.07.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së ankuesit Fran Dashi. Gjykata ka arsyetuar se ai është gjykuar nga gjykatat e të gjitha shkallëve, të cilat, në përfundim të gjykimit, kanë dhënë vendime gjyqësore që kanë marrë formë të prerë dhe në këto vendime janë vlerësuar të gjitha provat e

mbledhura gjatë hetimeve, duke marrë vlerën e provës gjatë gjykimit sipas KPP-së. Sipas gjykatës, çështja konsiderohet gjë e gjykuar sipas nenit 7 të KPP-së. Ajo ka vlerësuar se pretendimi se një person duhet të ishte marrë në përgjegjësi penale në një procedim penal të përcaktuar, në një kohë kur është pyetur si person që tregon rrethana të dobishme për qëllime të hetimit, nuk mund të çmohet kur për të njëjtin fakt dhe rrethana është hetuar, përfunduar hetimi, si dhe është gjykuar e marrë vendimi formë të prerë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

6. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 2457, datë 21.11.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 3466 akti, datë 24.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Sipas asaj gjykate, nga ana e Prokurorisë janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme verifikuese që japin kuadrin e plotë të faktit nëse ndodhemi para një vepre penale dhe në rastin konkret, nga verifikimet e kryera, ndryshe nga sa ka argumentuar ankuesi, nuk ndodhemi para ndonjë vepre penale. Ankuesi ka pretenduar se organi i prokurorisë duhet të hetonte në lidhje me një fakt, i cili në mënyrë të qartë del se është marrë në shqyrtim nga gjykatat në të tria shkallët e saj, si edhe nga Gjykata Kushtetuese. Për rrjedhojë, ajo gjykatë ka vlerësuar se veprimet hetimore verifikuese të prokurorisë janë në përputhje me procedurat ligjore, ndaj ankimi duhet rrëzuar si i pabazuar në ligj dhe në prova. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi.

7. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-106, datë 19.01.2023, në dhomë këshillimi, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas tij, të njëjtat pretendime kërkuesi i ka ngritur edhe përpara gjykatës së apelit dhe ka marrë përgjigje të arsyetuar në lidhje me to. Shumica e pretendimeve të ngritura u referohen çështjeve që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të fakteve dhe provave nga organet proceduese, të cilat nuk i përkasin juridiksionit eskuzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë, ndërsa nuk argumentohet shkelje e ligjit material ose procedural prej gjykatës së apelit. Ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, gjykata e apelit duke mbajtur në konsideratë pretendimet e kërkuesit, në ushtrim të funksionit të saj, ka analizuar vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal.

8. Në datën 12.04.2023 kërkuesi Fran Dashi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të mësipërm, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 20.04.2023.

II

Pretendimet e kërkuessit

9. **Kërkuesi** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt për këto shkaqe:

- 9.1. Provat shkresore për veprimet e shtetasit L.M. janë fshehur dhe nuk janë hetuar nga prokurori N.T., ndërkohë që prokuroria duhej të kishte kryer të gjitha verifikimet e trajtuara në kallëzimin penal. Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me prokuror A.D., duhej të kishte shpallur moskompetencën, pasi ka konflikt interesi, në kushtet që shtetasi N.T. ushtron detyrën në të njëjtën godinë. Prokurori A.D. nuk ka respektuar ligjin për të marrë në pyetje eprorët, ish-eprorët dhe kolegët e tij dhe nuk ka pyetur as personat që kishin dijeni për të vërtetën. Organi i akuzës ka detyrimin ligjor të hetojë nëse fakti ekziston apo nëse personat e kallëzuar e kanë kryer veprën penale, dhe për të realizuar këtë detyrim ligjor duhet të fillojë çështjen penale, të kryejë veprimet hetimore dhe pas tyre të shprehet për fatin e çështjes. Arsyetimi i prokurorisë në lidhje me mosfillimin e procedimit penal bie në kundërshtim me ligjin procedural dhe atë material penal.
- 9.2. Gjykata, e vënë në lëvizje me ankimin e kërkuessit, sipas nenit 291 të KPP-së, duhej të verifikonte nëse organi i akuzës ka zhvilluar hetime të plota dhe të gjithanshme, nëse janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore apo duhet të kryhen veprime të tjera të rëndësishme për çështjen. Vendimi i prokurorit për mosfillimin e procedimit penal është kryer brenda 5 ditësh, çka e bënte të pamundur verifikimin e vërtetësisë së faktit penal. Referuar nenit 290 të KPP-së, në rastin konkret mungon qartësia për mosekzistencën e faktit penal, ndaj nuk mund të disponohej me vendim për mosfillimin e procedimit penal. Duke qenë se vendimi është marrë në kundërshtim me dispozitat e KPP-së, gjykata duhej të urdhëronte prokurorinë që të regjistronte procedimin penal dhe të kryente hetime të nevojshme, duke përcaktuar drejtimin e tyre.
- 9.3. *Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, vendimi i Kolegjit Penal nuk përmban shkaqet e rekursit në bazë të të cilave është pretenduar ndryshimi i vendimeve gjyqësore dhe kjo përbën një të metë të pakapërcyeshme të vendimit dhe të arsyetimit të asaj gjykate. Kolegji Penal ka refuzuar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, edhe pse pretendimet kishin të bënin me

interpretimin e gabuar të ligjit penal dhe shkelje procedurale, duke mos riparuar shkeljet e procesit gjyqësor të zhvilluar në shkallët e tjera të gjykimit.

- 9.4. Është cenuar e drejta e aksesit, pasi edhe pse në rekurs janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor dhe këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje atyre.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesës

10. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

11. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej këtyre kriterëve që kërkuar të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyqimit kushtetues.

12. Kërkuar legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Lidhur me kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, individ mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual, vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ajo pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale

nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës pasi ka shteruar mjetet e ankimit në gjykatat e zakonshme, në formë dhe përmbajtje, për rrjedhojë për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese të pretenduara të cenuara, ai nuk ka mjet tjetër juridik efektiv në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

14. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Vendimi më i fundit gjyqësor i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 19.01.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 12.04.2023, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

15. Për sa i takon legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata ka theksuar se vlerësimi i fakteve dhe rrethanave të çështjes, si dhe interpretimi i ligjit janë kompetenca të gjykatave të sistemit gjyqësor të zakonshëm dhe, si të tilla, nuk mund të jenë objekt i gjykit kushtetues. Gjykata ka në kompetencën e saj vlerësimin nëse gjykatat e sistemit gjyqësor kanë respektuar të drejtat e palëve në gjykim për një proces të rregullt ligjor dhe nëse ato u kanë dhënë kuptimin e duhur të drejtave kushtetuese që duhen respektuar në procesin e shqyrtimit të çështjes (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Roli i saj nuk është të rivlerësojë faktet, zbatimin e ligjit ose zgjidhjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme. Kontrolli kushtetues që ushtron Gjykata nuk mund të zëvendësojë prerogativat kushtetuese e ligjore të vetë hallkave të sistemit gjyqësor dhe aq më tepër të vlerësojë bindjen e brendshme të gjykatave për çështje konkrete. Interpretimi i ligjit është atribut i gjykatave të zakonshme, për sa kohë nuk cenon ndonjë element të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 7, datë 07.02.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Bazuar në këto standarde, Kolegji vlerëson se pretendimet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e prokurorit dhe veprimet e kryera prej tij në lidhje me kallëzimin e paraqitur nga kërkuesi, si dhe me vlerësimin e gjykatave të zakonshme në lidhje me këtë veprimtari hetimore, kanë thelbësisht natyrë ligjore, pasi kanë të bëjnë me çështje të vlerësimit dhe shqyrtimit të provave, si dhe interpretimit të ligjit dhe, si të tilla, bëjnë pjesë në juridiksionin e zakonshëm gjyqësor. Kërkuesi nuk ka arritur t'i ngrejë këto pretendime në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë cenimin e ardhur në të drejtat e tij kushtetuese.

17. Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e standardit të arsytimit të vendimit dhe të së drejtës së aksesit nga Gjykata e Lartë, pretendime këto që *prima facie* kanë natyrë kushtetuese, ndaj do të analizohen në vijim. Kolegji vëren, gjithashtu, se për shkak të

natyrës së këtyre pretendimeve, ato do të shqyrtohen në këndvështrim të standardit të arsyetimit të vendimit të Kolegjit Penal.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor të lidhur me të drejtën e aksesit

18. Sipas kërkesit, vendimi i Kolegjit Penal nuk përmban shkaqet e rekursit në bazë të të cilave është pretenduar ndryshimi i vendimeve gjyqësore dhe kjo përbën një të metë të pakapërcyeshme të vendimit dhe të arsyetimit të asaj gjykate. Kolegji Penal ka refuzuar kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, edhe pse pretendimet kishin të bënin me interpretimin e gabuar të ligjit penal dhe shkelje procedurale, duke mos riparuar shkeljet e procesit gjyqësor të zhvilluar në shkallët e tjera të gjykimit. Sipas tij, edhe pse në rekurs janë ngritur pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor dhe këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje atyre.

19. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (shih vendimin nr. 10, datë 04.03.2021 të Gjykatës Kushtetuese). Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (shih vendimin nr. 43, datë 27.12.2022 të Gjykatës Kushtetuese).

20. Në aspektin e kontrollit kushtetues Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (shih vendimin nr. 23, datë 10.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese). Gjykata rithekson se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet arsyetim i detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë (shih vendimet nr. 80, datë 18.12.2017; nr. 34, datë 13.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Nga ana tjetër, Gjykata ka pohuar se detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka

qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Ajo nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.05.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Kolegji vëren se vendimi i Kolegjit Penal paraqitet i rregullt në formë, i qartë, koherent dhe pa kundërthënie në përmbajtje. Ai pasqyron në mënyrë të plotë palët ndërgjyqëse, rrethanat e çështjes, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit, pretendimet e parashtruara në rekurs nga kërkuesi, ligjin e zbatueshëm, si dhe arsyetimin dhe vlerësimin për çështjen. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, i ka dhënë përgjigje të arsyetuar se përse nuk bëjnë pjesë në ato të parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Kolegji Penal e ka vlerësuar të drejtë vendimmarrjen dhe arsyetimin e gjykatës së apelit, e cila ka shqyrtuar ankimin e kërkuesit, si dhe i ka dhënë përgjigje edhe pretendimit të kërkuesit për konflikt interesi nga prokurori i çështjes, shkak për të cilin ai duhej të shpallte moskompetencën, duke vlerësuar se në interpretim të nenit 78 të KPP-së, prokurori i kallëzuar N.T. nuk ka marrë asnjëherë cilësinë e të pandehurit, për rrjedhojë nuk kishte vend për shpalljen e moskompetencës për hetimin e kallëzimit të paraqitur nga kërkuesi.

23. Kolegji vlerëson se në rastin konkret, gjatë procesit gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi, nuk konstatohen shkelje të të drejtave kushtetuese dhe as që zbatimi i ligjit nga gjykatat të ketë qenë arbitrar, pra që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë sipas nenit 42 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, vetëm fakti se Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, nuk vë në dyshim të drejtën e tij për proces të rregullt.

24. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit të lidhur me të drejtën e aksesit është haptazi i pabazuar.

25. Si përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “a” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.